POSTIM ARKIVOR

# Rrëzimi i përmendores së Enver Hoxhës, 20 shkurt 1991

Rrëzimi i përmendores dhe situata e Sigurimit të Shtetit



SEKSIONI

1970-1991

PERIUDHA

1991 - 1991

Në shkurt të vitit 1991 Sigurimi i Shtetit ishte në një periudhë të vështirë, organizimi dhe veprimtaria e të cilit nuk mund të përshtateshin me zhvillimet e reja politike. Pas lëvizjeve politike të një viti më parë, futjes në ambasada, krijimit të Partisë Demokratike, si dhe pakënaqësive dhe kaosit që mbizotëronte në fillim të vitit 1990, Sigurimi i Shtetit po gjendej jashtë kompetencave, paaftësive dhe mundësive reale të zhvillimit të veprimtarisë së saj. Të gjitha kufizimet, vështirësitë, sfidat dhe nevojat paraqiten në një nga raportet e dala për datën 20 shkurt lidhur me rënien e përmendores së Enver Hoxhës.

RRËZIMI I PËRMENDORES · ENVER HOXHA · NDRYSHIMET DEMOKRATIKE · LEVIZJA STUDENTORE

PERMBAJTJE #1

# 20 shkurt 1991

Informacionet lidhur me rrëzimin e përmendores së Enver Hoxhës gjenden në fondin 4, dosjet nr. 117 dhe nr. 119 të vitit 1991. Dosjet përmbajnë informacion të detajuar mbi demonstratat dhe lëvizjet qytetare në Tiranë dhe rrethe gjatë fillimit të vitit 1991. Informacionet për rrëzimin e përmendores lidhen me të tjera ngjarje të atyre ditëve, si greva në ndërmarrje, miniera, shkolla apo me ato ngjarje që njihen si Greva e minierës së Valiasit, Puçi i Shkollës së Bashkuar, Lëvizja e Sindikatave të Pavarura, etj.

MEDIA #1

# Raport mbi ngjarjen e datës 20 shkurt 1991

MEDIA FAQE #1

18

SEKRET
Ekzemplar nr..3.
Tiranë, më 4..3.1991

1314.

RAPORT
MBI NGJARJEN E DATËS 20 SHKURT 1991

Meqënëse një raport përshkrues për ngjarjen e datës 20 shkurt 1991 është bërë, tërheqim edhe disa konkluzione si më poshtë :

1. Organet e Punëve të Brëndshme, në përgjithësi, janë treguar në lartësinë e detyrave, duke manifestuar, vetkuptohet edhe dukurit e jetës politiko shoqërore në vendin tonë. Ato treguan edhe besnikërinë ndaj Atdheut, edhe unitet, edhe gadishmëri, në një kohë kur nga pikpamja materialo-teknike u kanë munguar shumë gjëra dhe nga pikpamja organizative ishin të papërgatitura për të përballuar situatat e reja.

Mendojmë se ky duhet të jetë problemi themelor ku duhet të qëndrojmë duke nxjerrë të metat tona.

Së pari, nga ana jonë nuk iu bë një analizë e thellë situatave në lindje, shkaqeve objektive e subjektive të tyre; format e mënyrat e ngjarjeve në vende të veçanta, faktorëve të brëndshëm e të jashtëm, që ndikuan në to dhe si mund të reflektoheshin në vendin tonë. Po ashtu edhe ngjarjet e brëndshme, prej atyre të 2 korrikut, nuk iu nënshtruan një analize komplete, gjë që është planifikuar për vitin 1991, duke ngritur edhe grupet e punës. Kuptohet që në këtë difekt ndikuan edhe rrjedhja me shpejtësi e ngjarjeve më të reja. Kështu që mbizotëroi dinamika e përditëshme ndaj punës së studjuar e të menduar. Duhet thënë hapur se, me ndonjë përjashtim, në organet tona ka munguar puna e mirëfilltë studimore e shkencore, sepse ka patur një frenim subjektiv,

Raport mbi ngjarjen e datës 20 shkurt 1991

MEDIA FAQE #2

19

2.

të cilin sa kemi filluar t'a vëmë në një rrugë ende foshnjore. Për rrjedhojë kanë munguar analistët e vërtetë në organet tona.

Së dyti, mungesa e normimit ligjor ka ndikimin e tij jo të pakët. Muajtë e fundit organet e Punëve të Brëndshme më tepër janë marrë me përpilimin e akteve normative se sa me punë të mirëfilltë. Në fakt me vetinisiativë ne filluam grumbullimin e ligjeve të disa vendeve duke krijuar edhe grupet e punës për projektligjet dhe projektdekretet, sipas armëve. Ndërkohë, me njohjen zyrtarisht të pluralizmit, nga mezi i janarit hartuam një plan për të punuar në 4 drejtime paralelisht: Në fushën normative, organizative, operative dhe informative, meqëllim që të merrej plotësisht mendimi i bazës, përfshi edhe vendin dhe rolin e organeve tona në shtetin juridik, si dhe faktin që partitë politike nuk përbëjnë objekt të punës tonë, me përjashtim të tendencës së mundëshme për t'u krijuar një parti eventuale fashiste. Në këtë kuadër u përcaktuan edhe drejtimet për ndjekje të veprimtarisë antikushtetuese deri tek ato ndaj personit. Pra, në kushtet e pluralizmit politik, bien nga veprimi i plotë, dashje pa dashje, platforma dhe materialet e tjera direktive për organet e Punëve të Brëndshme. Mosmbajtja e një qëndrimi të qartë në këtë fushë mendojmë se krijoi një farë çoroditje edhe tek punonjësit tanë.

Së treti, puna me kuadrin ka patur difekte jo të vogla, për rrjedhojë në praktikë janë manifestuar edhe veprime të pakualifikuara, voluntariste, arbitrare që kanë cënuar. Janë bërë hapa të sforcuar, të cilët i hoqëm nga praktika e jonë sepse përveç dëmeve politike nuk i sillnin asnjë të mirë punës. Në politikën dhe punën me kuadrin ka patur difekte të tilla ku ka vegjetuar jo pak paaftësia sidomos në ndjekjen e tendencës së spiunazhit, etj. Në këtë fushë ka difekte edhe puna në shkollë, e cila duhet të marrë një

AIDSSH

Raport mbi ngjarjen e datës 20 shkurt 1991

MEDIA FAQE #3



vizion të ri në të ardhmen.

Së katërti, vitet e fundit u rritën ndjeshëm kontaktet me të huajtë, ndërsa ndjekja e tyre ishte tepër e dobët, sidomos ndaj afaristëve, tregëtarëve e të ftuarëve, që u bënë gjithnjë e më të decentralizuar nën prizmin e interesave ekonomike, aqsa çoi në një hermetizim të tyre ndaj organeve tona. Me krijimin e Degës së të huajve kjo punë u pozicionua diçka, megjithatë ajo kërkon kualifikim sëbashku me Degën për luftën kundër terrorizmit, shoqëruar edhe me paisje e mjete tekniko-shkencore.

Së pesti, nga pikpamja organizative organet tona nuk janë të zhdërvjellta, qoftë si degë, qoftë edhe si kuadër, sepse ka dublime, ka copëtime në detyrat funksionale, ka mosbashkëveprim ( kundërzbulimi dhe zbulimi janë pothuajse fare të shkëputur dhe të pasinkronizuar në detyra dhe strukturë me përjashtim të Degës së të huajëve dhe të dipllomatëve që i kemi përputhur kohët e fundit nga ana strukturore). Është detyrë e shpejtë që Sigurimi të dali më vehte dhe të varet nga Presidenti, por duke vepruar si një organ unik ( zbulim - kundërzbulim).

Së gjashti, muajtë e fundit edhe ajo forcë zbuluese masive që ishte, me elementë të veçantë cilësorë, u hutua, u tërhoq, u shpërbë. Në këtë difekt kanë ndikuar situatat, pasiguria për të ardhmen e saj, por ndoshta edhe një tërheqje ose mungesa e punës së kualifikuar nga punëtorët operativ të të gjithë sektorëve. Kjo do kohë e bindje të forta për t'u kapërcyer dhe ndoshta depolitizimi do të ishte një nga faktorët për përballimin e një situate të tillë, pa përjashtuar stimujt material që dalin në plan të parë.

2. Organet tona në dinamikën e punës kanë patur të dhëna për ngjarjet pasardhëse, përfshi edhe rrëzimin e bustit të Enver Hoxhës Ato kanë qarkulluar si dëshira për t'u kryer ose me dinamit ose në

AIDSSH

Raport mbi ngjarjen e datës 20 shkurt 1991

MEDIA FAQE #4



forma të tjera. Por asnjë të dhënë nuk kemi patur për datën, me përjashtim të sinjaleve indirekte se do të bëhet hataja në sheshin "Skëndërbej", në bllok e kështu me radhë. Aq më tepër nuk kemi patur të dhëna për një skenar të përgatitur se do të rrëzoheshin bustet edhe në rrethet e tjerë, të cilët në fakt u hoqën pasi Radio-Tirana njoftoi me bujë për ngjarjen në Tiranë. Pra kemi të bëjmë me një përpunim sistematik të ambienteve me të gjitha mjetet e format.

Masat mbrojtëse ndaj objekteve kryesore në Tiranë si nga Drejtoria e Punëve të Brëndshme dhe nga Ministria kanë qënë të përherëshme. Edhe për atakimet që i janë bërë shokut Enver është vepruar sipas ligjës, por organet e drejtësisë nuk kanë qënë efikase, bile kanë patur difekte edhe në proceset e mëparëshme aqsa u krijua bindja se organet e punëve të brëndshme të kapin, të drejtësisë të lëshojnë. Kjo kontradiktë çoi në stepje.

Që të nxjerrësh përgjegjësinë apo vetpërgjegjësinë për ngjarjen ( jo atë morale ) nuk është e lehtë. E themi këtë sepse nuk kanë për shkak themelor veprimin ose mosveprimin e organeve të punëve të brëndshme, por një sërë faktorësh.

Kuadrot dhe efektivat e Ministrisë së Punëve të Brëndshme janë tepër të shqetësuar për ngjarjet që ndodhën, për situatat që kaluam e ato eventuale, ndaj punojnë për të rritur mobilizimin në punë, meqëllim që të kryejnë sa më mirë detyrat e ngarkuara.

ZËVENDËSMINISTRI I PUNËVE TË BRËNDSHME
VEIP PRODA

AIDSSH

Raport mbi ngjarjen e datës 20 shkurt 1991

INFORMACION

## Raport mbi ngjarjen e datës 20 shkurt 1991

Autoret: Zv/ministri i Punëve të Brendshme

| | |
|---|---|
| FONDI | |
| BURIMI | AIDSSH |
| DATË | 20.02.1991 |
| HAPËSIRA GJEOGRAFIKE E VEPRIMTARISË | Tiranë |
| DOSJA | Nr. 117 |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

# Foto

MEDIA FAQE #1



Foto

MEDIA FAQE #2



Foto

MEDIA FAQE #3




Foto

MEDIA FAQE #4



Foto

MEDIA FAQE #5



Foto

INFORMACION

## Foto

Autoret: I paidentifikuar

| | |
|---|---|
| FONDI | |
| BURIMI | AIDSSH |
| HAPËSIRA GJEOGRAFIKE E VEPRIM-TARISË | Tiranë: Qyteti Studenti, sheshi "Skënderbej" |
| DATË | 20.02.1991 |
| KRIJUAR NGA | Autori i paidentifikuar |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #3

# Demonstrata e 20 shkurtit 1991

MEDIA FAQE #1

### Video e bashkangjitur

https://localhost:3000/get-asset/1a29418c-6d98-412f-b102-5f07d5679295

INFORMACION

## Demonstrata e 20 shkurtit 1991

| | |
|---|---|
| BURIMI | |
| DATA E KRIJIMIT | 20.02.1991 |
| GJUHA | Pa zë |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #4

# Mbi ndërprerjen e punës në disa ndërmarrje ekonomike në pëkrahje të studentëve grevistë

MEDIA FAQE #1



REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME — Sekret
DREJTORIA E PUNËVE TË BRËNDSHME — 1228/L 25.2.91 Ekz. Nr. 1
Nr. 621 Prot. — Tiranë, më 20.2 1991

Lënda: Mbi ndërprerjen e punës në disa ndërmarrje ekonomike në përkrahje të studentëve grevistë.

MINISTRIT PUNËVE TË BRENDSHME
SHOKUT HEKURAN ISAI

TIRANË

Në përgjigje të thirrjes së bërë nga sindikatat e pamvarura sot më dt.20.2.1991 kanë ndërprerë punën në përkrahje e solidaritet me studentët grevistë disa ndërmarrje ekonomike(pjesërisht dhe plotësisht)dhe kanë shkuar në qytetin"Studenti" puntorë të ndërmarrjeve ekonomike e konkretisht:

1.NGA RAJONI NR.1
-Kombinati i autotraktorëve "E.Hoxha"
-Ndërmarrja e Porcelanit
-Ndërmarrja Komunale Elektrike
-Ndërmarrja e ndërtimit të Minierave
-Ndërmarrja Artistike "Migjeni"
-Kombinati Poligrafik
-Uzina Gjeologjike
-Kinostudjo "SH. e Re"
-Ndërmarrja e lesh-punuesve

RAJONI NR.2
-Kombinati i Tekstileve(pjesërisht)
-Fabrika e Qelqit - plotësisht
-Uzina Elektromekanike - pjesërisht.

Mbi ndërprerjen e punës në disa ndërmarrje ekonomike në pëkrahje të studentëve grevistë

MEDIA FAQE #2



61)

2.

-Uzina"Enver("plotësisht )

-Parku i Udhtarëve (plotësisht)

-Ofiçina e Automjeteve të komunikacionit(plotësisht)

-Parku i mallrave (plotësisht)

-Ndërmarrja e punimit të veshjeve (plotësisht)

-Shtypshkronja ("Mihal Duri",(plotësisht)

NGA RAJONI NR.3:

-Uzina elektromekanike (plotësisht)

-Uzina abrazivit (plotësisht)

-Uzina "Dinamo" (plotësisht)

-Ndërmarrja Kimike (plotësisht)

-Uzina Dajti (plotësisht)

-Kombinati i mishit(plotësisht)

-Kombinati i qumështit(pjesërisht)

-Ndërmarrja elektrike (pjesërisht)

-Ndërmarrja ujësjellsit (pjesërisht)

-Uzina "Partizani" (plotësisht)

-Uzina "Tirana" (plotësisht)

-Uzina e PTT (plotësisht)

-Uzina e veglave bujqësore (pjesërisht)

-Kombinati "J.Pashko", pjesërisht

NGA RAJONI NR.4

-Miniera e Valiasit(pjesërisht)

Deri tani nuk kanë marrë pjesë dhe nuk janë solidarizuar me studentët ndërmarrjet:

-Kombinati "M.Mame"

-Fabrika e Bukës

AIDSSH

Mbi ndërprerjen e punës në disa ndërmarrje ekonomike në pëkrahje të studentëve grevistë

MEDIA FAQE #3



62)

3.

-Fabrika e Miellit

-Kombinati Ushqimor "A.Kelmendi"

DREJTORI I PUNEVE TE BRENDSHME

LAHEDIN BARDHI

AIDSSH

Mbi ndërprerjen e punës në disa ndërmarrje ekonomike në pëkrahje të studentëve grevistë

INFORMACION

# Mbi ndërprerjen e punës në disa ndërmarrje ekonomike në pëkrahje të studentëve grevistë

Autoret: Drejtoria e Punëve të Brendshme

| | |
|---|---|
| FONDI | |
| DOSJA | Nr. 147 |
| STRUKTURA | Drejtoria e Punëve të Brendshme |
| SASIA E FLETËVE | 220 |
| VITET EKSTREME | 04.01.1991-10.07.1991 |
| DATA E KRIJIMIT | 20.02.1991 |
| HAPËSIRA GJEOGRAFIKE E VEPRIMTARISË | Tiranë |
| KRIJUAR NGA | Lahedin Bardhi-Drejtor i Punëve të Brendshme |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.